
بسم الله الرحمن الرحیم

IMAMËT TANË

(Për të rinj)

Titulli**: Imamët tanë**
Autori: Husejn **AL SADR**
Përktheu: **Vullnet MERJA**
Redaktoi: **Liseda RAMAJ**
Përkujdesja kompjuterike: **Sabrie FEZA**
Botoi: Shoqata europiane për njohjen e besimeve
Tirazhi: 1000 kopje

PARATHËNIE

Imamati (prijësia) është një prej parimeve të fesë. Besimi në të arrihet nëpërmjet akides (besimit). Nuk lejohet ndjekja e besimit sipas traditës së familjes, as i edukuesve, sado të mëdhenj qofshin. Kjo është një detyrë logjike individuale, njëlloj si tek Teuhidi (Njëtimi) dhe Nubuveti (Profetësia).

Gjithashtu, ne besojmë se ajo është mirësi prej Allahut, siç është profetësia. Është e domosdoshme që në çdo kohë të jetë i pranishëm një imam udhëzues, zëvendës i profetit në detyrën e tij, për t'i udhëzuar njerëzit dhe për t'i drejtuar ata kah shpëtimi dhe lumturia në të dy jetët.

Imami ka po atë të drejtë si Profeti: vilajetin e përgjithshëm ndaj njerëzve në administrimin e çështjeve të tyre, të interesave të tyre, të vendosjes së drejtësisë në mesin e tyre dhe në zhdukjen e padrejtësisë e të armiqësisë mes tyre.

Bazuar në këtë, imamati është vazhdimësi e profetësisë. Argumenti që e bën të domosdoshëm dërgimin e profetëve e të të dërguarve, është i njëjtë me caktimin e imamëve pas Profetit.

Për këtë themi që imamati është vetëm me caktim nga Allahu me gjuhën e të dërguarit apo të imamit paraardhës. Imamati nuk bëhet me zgjedhje apo me votim të njerëzve.

Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *"Kush vdes dhe nuk e njeh imamin e kohës së tij, ai vdes me vdekje të xhahilijetit (kohës para Islamit)."*

Kështu që, nuk lejohet që një periudhë kohore të jetë e zbrazët, pa praninë e imamit, të cilit jemi të detyrurar t'i bindemi. Ai është i caktuar nga Allahu i Madhëruar - e pranojnë apo e kundërshtojnë njerëzit, e përkrahin apo nuk e përkrahin, i binden apo nuk i binden, është i pranishëm apo jo. Nuk ka dallim logjik mes fshehjes së gjatë dhe asaj të shkurtër.

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin e Shenjtë:

... وَلِكُلِّ قَوْمٍ هَادٍ ﴿٧﴾

"...E, për çdo popull ka udhërrëfyes." (Sure "Rra'ad", ajeti 7).

... وَإِن مِّنْ أُمَّةٍ إِلَّا خَلَا فِيهَا نَذِيرٌ ﴿٢٤﴾

Dhe: **"...nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur paralajmërues."** (Sure "Fatir", ajeti 24).

KUSHTET E IMAMATIT

Duhet që për imamin të plotësohen dy kushte:

Kushti i parë: Dija e plotë mbi Sheriatin (legjislacionin). Domethënë: Imami duhet të ketë njohje të detajuar për Sheriatin islam. Kjo bazohet në argumentet e mëposhtme:

1- Imami është përgjegjës për përhapjen e Sheriatit islam në mesin e njerëzve. Ai është përgjegjës për mbrojtjen e Sheriatit nga ndryshimet, nga devijimet, nga falsifikimet, nga zëvendësimet me ndonjë Sheriat tjetër apo me ligjet e vëna nga vetë njerëzit. Imami është përgjegjës për zbatimin e plotë të Sheriatit në shoqëri.

Është e qartë se kjo përgjegjësi kërkon që imami të jetë plotësisht i ditur me Sheriatin, me qëllim që të arrijë zbatimin e plotë të tij.

2- Imami është shembull për njerëzit. Ata i referohen atij në njohjen e Sheriatit islam dhe ndjekin jetëshkrimin e tij (imamit) në zbatimin e Sheriatit. Është e qartë se shembulli kërkon që imami të jetë i ditur për Sheriatin dhe ta zbatojë atë, me qëllim që njerëzit t'i besojnë atij dhe ta ndjekin atë.

Nëse imami nuk është i ditur për Sheriatin, apo nuk ka dije të plotë rreth tij, atëherë njerëzit nuk janë të sigurtë e të bindur në ndjekjen e tij. Ata nuk do ta ndjekin atë, sepse ai ka mundësi që t'ua mësojë gabim Sheriatin, për

shkak se nuk ka dije të plotë rreth tij. Prej ajeteve të Kur'anit që e përcakton si kusht të domosdoshëm dijen e plotë të imamit është edhe ajeti 35 i sures "Junus", i cili thotë: **"...E pra, pas cilit ia vlen të shkosh, pas atij që udhëzon në rrugë të drejtë apo pas atij, i cili as vetë nuk është në rrugë të drejtë, veç nëse e shpie dikush? Çfarë keni? Si po gjykoni kështu?!"**

...أَفَمَن يَهۡدِيٓ إِلَى ٱلۡحَقِّ أَحَقُّ أَن يُتَّبَعَ أَمَّن لَّا يَهِدِّيٓ إِلَّآ أَن يُهۡدَىٰۖ فَمَا لَكُمۡ كَيۡفَ تَحۡكُمُونَ ٣٥

Shpjegim: Në këtë ajet Allahu u drejtohet njerëzve në formë pyetësori duke u thënë: Cili është më i merituesshëm për ndjekje e referim, për t'u njohur me Sheriatin, imami që udhëzon në rrugë të drejtë (që është i ditur plotësisht me Sheriatin), apo ai që nuk udhëzon në rrugë të drejtë dhe ka nevojë për dikë tjetër që ta udhëzojë në rrugë të drejtë (i cili nuk është i ditur plotësisht me Sheriatin)?!

Allahu u drejtohet njerëzve që ata të mos e ndjekin atë imam që nuk është i ditur plotësisht rreth Sheriatit. Por, ata duhet të ndjekin atë imam që është i ditur plotësisht me Sheriatin, sepse ai është më i merituesshëm për t'u ndjekur. Për këtë, në fund të ajetit Allahu i Madhëruar thotë: **"...Çfarë keni? Si po gjykoni kështu?!"** Që do të thotë: Si gjykoni se mund të lejohet ndjekja e atij imami që nuk është i ditur plotësisht për Sheriatin?! Ju e dini se njerëzit nuk kanë siguri dhe nuk janë të bindur që ai ka dije të

plotë rreth Sheriatit, sepse ai mund të gabojë në mësimin, në zbatimin dhe në predikimin e Sheriatit.

Rreth kushtit të të qenit imam i ditur me dije të plotë rreth Sheriatit, imam Rizai (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "*Imami duhet të ketë dituri të plotë rreth Sheriatit, të jetë njohës i plotë i rregullave, njohës i çështjeve të udhëheqjes dhe njohës i çështjeve të drejtimit dhe admistrimit të shtetit.*"

Kushti i dytë: Pagabueshmëria *(el ismetu)*

Kuptimi i saj është: Imami duhet ta praktikojë plotësisht Sheriatin në jetën e tij. E kjo bazohet në argumentet e mëposhtme:

1- Imamati është premtim i Allahut që ia jep atij që është i pagabueshëm. Domethënë, imamati është përgjegjësi madhështore me të cilën Allahu ngarkon vetëm ata që e meritojnë ta mbartin atë. Këtë e kuptojmë edhe nga dialogu mes Allahut dhe të Dërguarit të Tij Ibrahimit (Paqja qoftë mbi të!), të cilin e përmend Kur'ani i Shenjtë në ajetin 124 të sures "El Bekare":

...قَالَ إِنِّي جَاعِلُكَ لِلنَّاسِ إِمَامًا ۖ قَالَ وَمِن ذُرِّيَّتِي ۖ قَالَ لَا

يَنَالُ عَهْدِي ٱلظَّٰلِمِينَ ﴿١٢٤﴾

"...Allahu i tha: 'Unë do të të bëj ty imam (prijës) **të njerëzve!' – 'Po pasardhësit e mi?' - pyeti ai. Allahu tha: 'Premtimi Im nuk i përfshin të padrejtët.'"**

Kuptimi i ajetit të begatë

Allahu i Madhëruar i tha profetit Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!): "Unë të kam caktuar ty imam për njerëzit." Ibrahimi (Paqja qoftë mbi të!) e pyeti Allahun: "Po pasardhësit e mi? A do t'i caktosh imamë për njerëzit?" Allahu iu përgjigj atij duke i thënë: "Imamati nuk i jepet atij që është i padrejtë." Me këtë përgjigje të Allahut të Madhëruar për Ibrahimin (Paqja qoftë mbi të!) kuptojmë domosdoshmërinë e kushtit të pagabueshmërisë tek imami.

Meqenëse Imamati është premtim i Allahut dhe përgjegjësi madhështore, atëherë atë e mbart vetëm ai person që është i pagabueshëm dhe e mban plotësisht këtë përgjegjësi. Kjo përgjegjësi nuk i jepet një të padrejti, sepse i padrejti nuk e kryen ashtu siç duhet përgjegjësinë e imamatit. Madje, ai as vetë nuk i zbaton rregullat e Sheriatit. Për këtë ai është i padrejtë ndaj vetes së tij. Me moszbatimin e rregullave të Sheriatit ai është tradhtar ndaj vetes dhe përcjellësit të Sheriatit. Meqenëse ai vetë nuk i zbaton rregullat e Sheriatit, atëherë ai nuk do të jetë në gjendje as t'i praktikojë ato në shoqëri dhe as t'i predikojë ato në mesin e njerëzve. Kështu, ai do të jetë i padrejtë ndaj bashkësisë. Pra, ai është tradhtar dhe i padrejtë ndaj bashkësisë për shkak të moszbatimit dhe të mospredikimit të rregullave të Sheriatit.

Meqenëse imami është shembull për njerëzit, të cilët i referohen atij për t'u njohur me rregullat e Sheriatit dhe që ndjekin jetëshkrimin e tij, atëherë duhet që imami të jetë i pagabueshëm. Nëse nuk është i tillë, pra, nëse ai gabon në

predikimin e Sheriatit a në mësimin e tij, apo nëse nuk i respekton rregullat e Sheriatit në jetën e tij, ai nuk e meriton të jetë shembull. Njerëzit nuk do t'i besojnë as fjalëve e as veprave të tij. Ata nuk do të jenë të bindur se fjalët dhe veprat e tij janë në përputhje me rregullat dhe dispozitat e Sheriatit.

TERMAT

Imamati është mëkëmbësia e profetësisë

Imami është mëkëmbësi i Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij).

Përgjegjësia e imamit është udhëheqja e ymetit, mbrojtja e përhapja e Islamit dhe interesimi e përkujdesja për çështjet e njerëzve.

Imam Rizai (Paqja qoftë mbi të!) i përshkruan këto tre terma si vijon:

1- Imamati është mëkëmbësi e Allahut dhe e të Dërguarit.

2- Imami është besniku (i besueshmi) i Allahut te krijesat e Tij, argument i Tij për robtë e Vet, mëkëmbësi i Tij në tokë, thirrësi në rrugën e Allahut dhe mbrojtësi i Islamit.

3- Përgjegjësia e imamit është të përhapë të lejuarat e Allahut dhe të ndalojë të ndaluarat e Tij, të zbatojë

rregullat e Sheriatit, të mbrojë fenë e Allahut, të ftojë në rrugën e Allahut me urtësi, me këshilla të përkryera dhe me argumente të drejta e të arsyeshme.

IMAMATI

Imamati ka kuptimin se profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka caktuar një zëvendës të vetin që të kryejë udhëzimin e njerëzve në vend të tij. Ky zëvendës quhet imam (prijës). Dymbëdhjetë Imamët, sipas renditjes, janë:

1- Imam Ali ibn Ebi Talib (Paqja qoftë mbi të!). Babai i tij është Ebu Talibi dhe nëna e tij është Fatime bintul Esed. Është varrosur në Nexhefin e Bekuar.

2 - Imam Hasan Ez Zekij (Paqja qoftë mbi të!). Është varrosur në Medinen e Ndritur.

3- Imam Hysejni (Paqja qoftë mbi të!), martiri i Qerbelasë. Është varrosur në Qerbelanë e Shenjtë.

4- Imam Sexhadi, Ali ibn Hysejn (Paqja qoftë mbi të!). Është varrosur në Medinen e Ndritur.

5- Imam Bakir, Muhamed ibn Ali (Paqja qoftë mbi të!). Është varrosur në Medinen e Ndritur.

6- Imam Sadiku, Xhafer ibn Muhamed (Paqja qoftë mbi të!). Është varrosur në Medinen e Ndritur.

7- Imam Kadhim, Musa ibn Xhafer (Paqja qoftë mbi të!). Është varrosur në Kadhimijeh – Bagdad, Irak.

8- Imam Riza, Ali ibn Musa (Paqja qoftë mbi të!). Është varrosur në Mashhad (Khorasan) – Iran.

9- Imam Xhevad, Muhamed ibn Ali (Paqja qoftë mbi të!). Është varrosur në Kadhimijeh – Bagdad, Irak.

10 - Imam El Hadij, Ali ibn Muhamed (Paqja qoftë mbi të!). Është varrosur në Samarra, Irak.

11- Imam El Askerij, Hasan ibn Ali (Paqja qoftë mbi të!). Është varrosur në Samarra, Irak.

12- Imam El Muntedhar (i prituri), Muhamed ibn Hasan El Mehdi (Allahu ia shpejtoftë ardhjen!). Ai është i gjallë, i fshehur dhe do të shfaqet me lejen e Allahut dhe do të përhapë drejtësinë në tokë.

Kushdo që beson në këta imamë, ai është shiit (pasues, ndjekës, ithtar).

Ne jemi ndjekësit (shiitët) e Ehli Bejtit, sepse pas profetit Muhamed ne pasojmë imamët prej familjes së Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

PRIJËSI I BESIMTARËVE, IMAM ALIU

(Paqja qoftë mbi të!)

Ai është Aliu, i biri i Ebu Talibit, i biri i Abdul Mutalibit, i biri i Hashimit, i biri i Abdul Menaf…

Është djali i xhaxhait të profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe bashkëshorti i vajzës së tij, Fatime Zahra (Paqja qoftë mbi të!).

Lindja e tij

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) lindi në Qaben e Bekuar, 30 vjet pas vitit të Elefantit, më 13 Rexheb.

Edukimi i tij

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) u edukua në shtëpinë e të Dërguarit të Allahut, profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Atë e edukoi profeti Muhamed dhe e përgatiti për të mbajtur përgjegjësinë e predikimit e të

përhapjes së Thirrjes islame dhe për të përçuar mesazhin e tij të Shenjtë.

Islami i tij

Imam Aliu e pranoi Islamin që në kohën kur profeti Muhamed u kthye nga Shpella e Hirasë. Ai mbante mbi supe mesazhin islam për mbarë njerëzimin. Ai ka qenë i pari mashkull që e prani Islamin dhe askush nuk e ka paraprirë atë në Islam, përveç profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Parimet islame kanë qenë të parat parime që ai përqafoi. Ai nuk ka përqafuar asnjë parim prej parimeve të xhahilijetit (kohës para Islamit) e të mosbesimit (el kufru).

Pasi imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) e pranoi Islamin, profeti Muhamed filloi ta përgatiste për të mbajtur përgjegjësitë shumëdimensionale të Thirrjes. Këtë e bënte edhe në prani të sahabëve të tjerë, me qëllim që ata të kuptonin se ky do të ishte mbartësi dhe përçuesi i mesazhit të Profetit pas vdekjes së tij dhe zëvendësi i tij.

Qëndrimet e imamit në përhapjen e thirrjes islame

E gjithë jeta e imam Aliut ka qenë Islam. Ai nuk kurseu asgjë nga mundësitë dhe fuqitë e tij në rrugën e përhapjes së Mesazhit islam. Të gjithë jetën e tij, nga fillimi

e deri në fund, imam Aliu (Paqja qoftë bi të!) ia kushtoi Islamit. Në historinë islame përmenden shumë ndodhi e ngjarje, në të cilat qartësohet qëndrimi dhe përkushtimi i imam Aliut për Islamin dhe për përhapjen e tij. Ndër to përmendim:

1- Fjetja e tij në shtratin e profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në kohën kur idhujtarët mekas përgatitën kurthin e vrasjes së Profetit.

2- Drejtimi i karvanit të emigruesve nga Meka e Bekuar për në Medinen e Ndritur nga ai.

3- Trimëritë e tij të pashoqe në betejat e ndryshme si: në betejën e Bedrit, të Uhudit, të Khandakut, të Khajberit, të Hunejnit dhe në çlirimin e Mekës.

Khilafeti (prijësia) i tij

Ne besojmë se prijësia e imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) është menjëherë pas vdekjes së profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Kjo bazohet në argumentet vijuese:

1- Tekstet e qarta të Profetit, me të cilat ai caktoi imam Aliun (paqja qoftë mi të!) si zëvendës të tij pas largimit nga kjo botë. Gjithashtu, me këto tekste Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e përforconte pozitën e zëvendësit të tij. Prej



fjalimeve më të njohura të profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) është ai që ka mbajtur në ditën Gadijr Khum (më 18 të muajit Dhul Hixheh), kur po kthehej nga haxhi i Lamtumirës.

2- Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ishte më i merituesshmi për të mbajtur përgjegjësinë e zëvendësit të profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), sepse tek ai gjendeshin dy kushte të imamatit (prijësisë):

a- Ai ka qenë i pagabueshëm (ma'sumun). Kjo bazohet në argumentet e mëposhtme:

Së pari: Personaliteti i tij që në fillim ka qenë i pastër e i plotë islam. Ai kurrë nuk iu përul diçkaje tjetër, përveç Allahut Fuqiplotë. Ai zbatonte me përpikëri rregullat e Sheriatit të Allahut dhe kurrë nuk devijoi e as nuk neglizhoi në zbatimin e tyre në jetën e tij.

Së dyti: Kur'ani dëshmon për pagabueshmërinë e tij në ajetin:

إِنَّمَا يُرِيدُ ٱللَّهُ لِيُذْهِبَ عَنكُمُ ٱلرِّجْسَ أَهْلَ ٱلْبَيْتِ وَيُطَهِّرَكُمْ تَطْهِيرًا ﴿٣٣﴾

"...O familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë

plotësisht."[1] Sigurisht, Aliu është pjesëtari i dytë i Ehli Bejtit (Familjes së Profetit) që përmenden në këtë ajet.

Së treti: Dëshmia e profetit Muhamed rreth pagabueshmërisë së tij. Hadith: *"Aliu është me të vërtetën dhe e vërteta është me Aliun. Ata nuk ndahen kurrë nga njëri-tjetri, derisa të vijnë tek unë te Burimi (el haudh)."*

Imam Aliu ka qenë më i dituri për Sheriatin. Këtë e dëshmojnë shumë hadithe të profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ndër to përmendim: "*Unë jam qyteti i diturisë, Aliu është porta e tij."* Dhe: "*Më i drejti juaj në gjykim, është Aliu."*

Mirëpo, faktorët historikë bënë që imam Aliu të mos e merrte në dorë udhëheqjen, për të mbrojtur unitetin e myslimanëve, për të ruajtur radhët e myslimanëve nga përçarja dhe për të forcuar bazat e Islamit. Imam Aliu iu drejtua lëvizjes kulturore e ideologjike dhe çështjeve të qeverisjes, kur e kërkonte nevoja dhe interesi i përgjithshëm.

Pas vrasjes së Othman ibn Affanit (në vitin 35 të hixhrit), imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) mori në dorë udhëheqësinë. Prej veprave më të rëndësishme reformuese që bëri imami, ishin si vijon:

1- Shkarkimi i mëkëmbësve të Othmanit dhe llogaridhënia e tyre për veprat që kishin bërë, të cilat ishin në kundërshtim me Sheriatin.

[1] Sure "Ahzab", ajeti 33.

2- Anullimi i sistemit të shpërndarjes së parave të mbledhura nga taksat, të cilin e shpiku Umer ibn Khatabi dhe e konfirmoi Othmani. Ai sistem nuk bazohej në barazi. Imam Aliu e riktheu ashtu siç ishte në kohën e profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), i cili bazohej tek barazia.

3- Rikthimi i të gjitha pasurive që u shpërndanë sipas sistemit të shpikur.

4- Pastrimi i kuptimeve dhe i mendimeve islame, të cilat u deformuan pas vdekjes së profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

5- Rezistenca ndaj grupit kundërshtues, i cili e kundërshtoi në zbatimin e sistemit islam në betejat e Basras, të Sefijit dhe të Nahravanit.

Vdekja e tij

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) vdiq në muajin e Ramazanit në vitin 40 të hixhrit. Ai u godit me shpatë në kokë për shkak të zbatimit të intrigës së khavarixhëve, të cilët vendosën ekzekutimin e të gjithë kundërshtarëve në çdo vend, që i kundërshtonin idetë dhe mendimet e khavarixhëve.

Porosi të imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!)

Veprimi sipas *synet*it dhe shmangia nga risitë: "*Dijeni, o krijesa të Zotit: Këtë vit, një besimtar duhet ta shikojë si të ligjshme gjithçka që ka parë si të ligjshme edhe vitin e kaluar, dhe ta konsiderojë si të paligjshme atë që e ka konsideruar si të paligjshme edhe vitin e kaluar. Sigurisht, dallimet intelektuale mes njerëzve nuk mund ta bëjnë të ligjshme atë që është shpallur si e paligjshme; se e ligjshme është ajo që e ka bërë Zoti të ligjshme, dhe e paligjshme është ajo që e ka bërë Zoti të paligjshme. Ju i keni provuar tashmë këto gjëra dhe keni gjykuar për vlerën e tyre. Juve ju është predikuar nga ata që jetuan përpara jush e ju janë dhënë shembuj dhe ju është bërë thirrje për faktin e qartë. Vetëm i shurdhri mund të mbetet shurdh ndaj saj e vetëm i verbri mund të mbetet i verbër ndaj saj.*

Ai që nuk mund të nxjerrë mësim nga historitë e ndodhitë që Zoti bën kaq dhembshurisht të ndodhin përditë rreth e rrotull tij, nuk mund të nxjerrë dobi nga asnjë këshillë. Ai do të ballafaqohet me humbje në jetën e tij e do ta gjykojë përherë të drejtën si të padrejtë dhe të padrejtën si të drejtë. Njerëzit janë të dy kategorive: pasues të Sheri'atit dhe nismëtarë të ndryshimeve e të risive, që Zoti s'i dëshmon përmes synetit dhe as në dritën e ndonjë argumenti tjetër."

Udhëheqja përmes Kur'anit të Shenjtë:

"Zoti s'ka këshilluar njeri jashtë frymës së Kur'anit, sepse ai është udhërrëfyesi e mjeti më i besueshëm i Tij. Ai përmban lulishte për zemrën e burime për dijen. Nuk ka interpretim tjetër për zemrën e mendjen njerëzore, veç Kur'anit. Medet! Kanë vdekur tashmë ata që e kuptonin dhe e kishin si udhëzim, po janë gjallë ata që e kanë harruar e hiqen sikur e kanë harruar. Nëse shikoni ndonjë të mirë, mbështeteni, e nëse shikoni ndonjë të keqe, i largoheni, sepse Profeti i Zotit thoshte shpesh: 'O bir i Ademit, ushtroje të mirën dhe largohu nga e keqja; se vetëm kështu, ndiqet udha e drejtë'."[2]

"NEHXHUL BELAGA"

Ky është libri që përmban urtësi, ligjërata, porosi e letra të mrekullueshme të prijësit të besimtarëve, imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!).

Grumbulluesi i librit "Nehxhul Belaga"

Ai është Sejjid Esh Sherijf err Rradhij, prej dijetarëve dhe letrarëve të shekullit të katërt të hixhrit.

Metodologjia e librit "Nehxhul Belaga"

[2] *Kulmet e Fjalës*, ligjërata 176.

Nehxhul Belaga ka një metodologji të lartë në letërsi që vjen pas Kur'anit dhe thënieve të profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshi mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ai dallohet për nga mendimi i thellë, vërtetësia në shprehje dhe mrekullia sqaruese. Ka ëmbëlsi në shprehje, bukuri në përçimin e kuptimit, tërheqje mahnitëse e ndikuese te lexuesi dhe dëgjuesi.

Rëndësia e librit "Nehxhul Belaga"

"*Nehxhul Belaga*" konsiderohet si një prej burimeve madhore që e ka ruajtur trashëgimia jonë bashkëkohore.
Rëndësia e këtij libri:

Ai konsiderohet burim dhe referencë për gjuhën dhe letërsinë arabe.

Ai konsiderohet referencë për shkencat e besimit islam.
Ai konsiderohet referencë për shkencat e legjislacionit islam .

Ai konsiderohet referencë për historinë në fillim të Islamit, para Islamit dhe për popujt e mëparshëm.
Ai konsiderohet referencë i shumë prej njohjeve të përgjithshme si: edukimi, morali, sociologjia, ana shpirtërore, administrimi, politika etj.

Përmbajtja e librit "Nehxhul Belaga"

Nehxhul Belaga përmban:



236 ligjërata e pjesë të shkëputura nga imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), 79 letra dhe 480 urtësi.

Disa prej pjesëve të përmbajtjes së tij të mrekullueshme janë: ligjërata e Teuhidit, porosia e imamit (Paqja qoftë mbi të!) për djalin e tij, imam Hasanin (Paqja qoftë mbi të!) dhe letra dërguar Malikul Eshter, mëkëmbësit të imamit në Egjipt.

Porosia e imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) **për djalin e tij, imam Hasanin** (Paqja qoftë mbi të!)

"O biri im! Të porosis që të jesh i devotshëm ndaj Allahut, të zbatosh urdhrat e Tij, ta mbushësh zemrën tënde me përmendjen e Tij dhe të kapesh pas litarit (fesë) të Tij. A ka lidhje më të fortë se mes teje dhe Allahut nëse ti e zbaton atë..."

Porosia e imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) **drejtuar Maliku El Eshter**

Në kohën që Aliu, Prijësi i besimtarëve, e bën guvernator të Egjiptit Malik ibn Harith El Eshterin, e urdhëron për administrimin e të ardhurave të tij, për luftimin e armiqve të tij, për mirëqenien e popullit të tij dhe lulëzimin e qyteteve të tij.

Ai e porosit t'i përkushtohet Zotit, ta pëlqejë bindjen ndaj Tij dhe të përmbushë ç'është urdhëruar në Kur'an përmes porosive të Tij të detyrueshme e të këshillueshme dhe pa u bërë i ashpër kurrë, përveçse kur luftohet e padrejta dhe shpërfillet e drejta. Zoti ka marrë përsipër, me

Emrin e Tij të Madh, që të ndihmojë këdo që e mbështet dhe të mbrojë këdo që e përkrah.

Ai e porosit gjithashtu që ta mposhtë veten (nefsin) nga pasionet dhe ta mbajë nën kontroll, sepse **"...shpirti** (i njeriut) **është fort i prirur për të keqe, përveç atij që e mëshiron Zoti im..."**.[3]

Prej urtësive të imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!)

"Lavdëro atë që është i ashpër me ty dhe të këshillon! Mos e lavdëro atë që të ledhaton me fjalë e që të lajkaton!"
"Të këqijtë ndjekin të këqijat e njerëzve dhe braktisin të mirat e tyre, ashtu siç ndjek miza vendet e ndyta."

[3] Sure "Jusuf", ajeti 53.

IMAM HASANI, I BIRI I ALIUT

(Paqja qoftë mbi të!)

Lindja e tij

Imam Hasani lindi në Medinen e Ndritur, më 15 Ramazan, në vitin e tretë të hixhrit.

Rritja dhe edukimi i tij

Imam Hasani jetoi e u rrit në praninë e gjyshit të tij, profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe nën kujdesin e nënës së tij për shtatë vjet. Jetoi me babanë e tij deri në vitin 40 të hixhrit, vit, në të cilin ndërroi jetë imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!).

Në periudhën që imam Hasani jetoi me gjyshin e tij, me nënën dhe babanë e tij, u edukua me fenë e pastër islame. Me anë të kësaj edukate islame, u formua personaliteti i tij i plotë e i pastër islam.

Udhëheqësia (khilafeti) **e tij**

Postin e udhëheqësisë e mori pas vdekjes së babait të tij, imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) në vitin 40 të hixhrit. Prej veprave që ai bëri në kohën që mori udhëheqësinë (khilafetin), ishte udhëheqja e ushtrisë së babait të vet (Paqja qoftë mbi të!), të cilin e përgatiti për të luftuar Muavijen ibn ebi Sufjan, sepse ai kundërshtoi urdhrin e imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) për të dhënë dorëheqjen prej postit të mëkëmbësit në Sham dhe devijoi nga mësimet dhe rregullat e islame gjatë ushtrimit të përgjegjësisë së mëkëmbësit. Mirëpo, për shkak të disa faktorëve, imam Hasani (Paqja qoftë mbi të!) nuk arriti ta shkatërronte Muaviun me anë të kësaj ushtrie. Prej këtyre faktorëve, më të rëndësishmit ishin:

1- Tradhtia e komandantit të ushtrisë, për shkak se Muaviu e joshi atë me para, pasuri dhe premtime.

2- Përçarja e rreshtave të ushtrisë për shkak të infiltrimit të një grupi të Muavijes në mesin e tyre.

3- Prania e khavarixhëve në ushtri, të cilët shfrytëzuan përçarjen dhe bënë ndarjen dhe shpërbërjen e ushtrisë.

Pajtimi i Imam Hasanit (Paqja qoftë mbi të!) **me Muaviun**

Pas shpërberjes së ushtrisë së Imam Hasanit (Paqja qoftë mbi të!) dhe shkatërrimit të saj, situatat politike në atë kohë e shtynë imam Hasanin që të bënte pajtim me

Muaviun dhe të binin dakord për paqe. Imam Hasani (Paqja qoftë mbi të!) bëri marrëveshje me Muaviun bazuar në disa kushte. Ato më të rëndësishmet ishin:

1- Imam Hasani duhet t'ia dorëzonte udhëheqësinë Muaviut, me kusht që të vepronte sipas Librit të Allahut dhe synetit të profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe të ndiqte jetëshkrimin e punëmirëve.

2- Pas vdekjes së Muaviut, udhëheqja duhet t'i kalonte imam Hasanit, nëse do të ishte gjallë. E nëse nuk do të ishte gjallë, atëherë udhëheqja do t'i kalonte vëllait të tij, imam Hysejnit (Paqja qoftë mbi të!) dhe Muaviut nuk do t'i lejohej që udhëheqjen t'ia kalonte dikujt tjetër. Mirëpo, kur mori në dorë pushtetin, ai nuk i zbatoi kushtet dhe i tradhtoi ato.

Faktorët e marrëveshjes

Faktorët më të rëndësishëm të marrëveshjes ishin:

1- Poshtërimi i irakenëve nga ana e bandave të Muaviut, të cilët i sulmonin ata në kohën e imam Aliut, për shkak të triumfit të tij.

2- Largimi i shumë personaliteteve shoqërore nga imam Hasani (Paqja qoftë mbi të!), ndër të cilët, kishte prej atyre që ia dhanë besën atij nga lakmia për pushtet dhe pasuri. Kjo për arsye se imam Hasani (Paqja qoftë mbi të!) kishte si parim aftësinë dhe besnikërinë. Gjithashtu,

bazohej në parimin e barazisë në shpërndarjen e pasurive që vinte nga taksat, duke zbatuar drejtësinë islame.

3- Hyrja e dyfytyrakëve, e spiunëve dhe e agjentëve të Muavijes në mesin e grupit të imam Hasanit (Paqja qoftë mbi të!) për ngatërresë dhe dobësim.

4- Tërheqja e shumë prej irakenëve, të cilët i dhanë besën Imam Hasanit (Paqja qoftë mbi të!) për ta luftuar Muaviun dhe mosdalja e tyre në xhihad me Imamin për shkak se u mashtruan.

5- Dërgimi i letrave tek Muaviu fshehurazi nga ana e irakenëve, në të cilat shprehej dashuria dhe pëlqimi për Muaviun dhe tradhtia ndaj Imam Hasanit (Paqja qoftë mbi të!). Kjo tradhti ndodhi në mesin e individëve të ushtrisë, me qëllim shkatërrimin e dobësimin e saj.

Vdekja e tij

Imam Hasani (Paqja qoftë mbi të!) vdiq në Medinen e Ndritur, në vitin 50 të hixhrit.

Prej porosive drejtuar shokëve të tij

"Puno në këtë jetë sikur do të jetosh përgjithmonë dhe puno për Ahiretin tënd sikur do të vdesësh nesër!"

"Nëse dëshiron krenarinë, paso farefisin dhe nëse dëshiron madhështi pa pushtet, atëherë largohu nga poshtërsia e gjynaheve ndaj Allahut të Madhëruar dhe hyr në bindjen ndaj Tij!"

"Nëse njerëzit nevojtarë të ftojnë për shoqërim, atëherë shoqërohu me atë që të vlerëson!"

Prej porosive për fëmijët e tij

"O biri im! Mos qorto njeri derisa të njohësh sjelljen e tij! Nëse njihesh me sjelljen e tij dhe je i kënaqur me shoqërinë e tij, pranoje prej tij faljen dhe shoqëroje atë në vështirësitë e tij!"

Prej porosive të tij të përgjithshme

"O robtë e Allahut! Merrni mësime prej ndodhive nga të cilat përftohen këshilla! Nxirrni mësime prej gjurmëve të njerëzve të shkuar! Përfitoni nga porsitë! Allahu është mbrojtësi dhe përkrahësi. Libri është i mjaftueshëm për argument dhe dallues mes së vërtetës dhe së pavërtetës…"

Prej veprave të rëndësishme që bëri kur mori misionin e imamatit (udhëheqësisë) **ishin:**

1- Vazhdimësia e mbrojtjes së mesazhit islam.

2- Rezistenca ndaj devijimit që gjendej në shoqërinë islame.

3- Udhëheqja dhe drejtimi i lëvizjes së myslimanëve në Kufe kundër pushtetit të devijuar emevit.

4- Martirizimi i tij në Kerbela për të ringjallur parimet islame, të cilat donin t'i zhduknin padrejtësitë dhe shtypjet emevite.

IMAM HYSEJNI, I BIRI I ALIUT

(Paqja qoftë mbi të!)

Imam Hysejni (Paqja qoftë mbi të!) lindi në Medinen e Ndritur, në vitin e katërt të hixhrit.

Rritja dhe edukimi i tij

Imam Hysejni (Paqja qoftë mbi të!) jetoi me gjyshin e tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshi mbi të dhe mbi familjen e tij!), me babanë e tij, prijësin e besimtarëve, imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!), me nënën e tij, Zahranë (Paqja qoftë mbi të!) dhe me vëllanë e tij, imam Hasanin (Paqja qoftë mbi të!). Ky rreth familjar i siguroi atij një edukim të pastër islam, njësoj si vëllai i tij, imam Hasani (Paqja qoftë mbi të). Mbështetur mbi themelet e këtij edukimi u formua personaliteti i tij i pastër e i plotë.

Imamati i tij

Pozitën e imamit imam Hysejni e mori pas vdekjes së vëllait të tij, imam Hasanit (Paqja qoftë mbi të!), në vitin 50 të hixhrit. Prej veprave më të rëndësishme që ndërmori gjatë udhëheqësisë (imamatit) ishin:

Ndodhia e Kerbelasë

Jezidi, biri i Muaviut, sunduesi emevit në kohën e imam Hysejnit (Paqja qoftë mbi të!), ishte i padrejtë, i devijuar nga rregullat dhe mësimet islame. Në kohën e tij, gjendja sociale dhe politike ishte shumë e shkatërruar.

Besimtarët e sinqertë në Irak prej pasuesve të Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!) gjithmonë përpiqeshin të ndreqnin situatën politike e sociale me mënyra të ndryshme paqësore. Por nuk arritën të bënin asgjë. Ata kryen lëvizje ndarëse që kishin si qëllim ndarjen e Irakut nga udhëheqja emevite dhe zgjodhën imam Hysejnin (Paqja qoftë mbi të!) si khalif të myslimanëve. E mbasi imam Hysejni të merrte në dorë udhëheqjen në Irak, ata do të përpiqeshin ta ndreqnin situatën e përgjithshme nën drejtimin e tij në pjesën tjetër të vendeve islame dhe të shpëtonin nga qeverisja e padrejtë emevite.

Ata morën në dorë situatën e përgjithshme në Kufe dhe i shkruan imam Hysejnit (Paqja qoftë mbi të!) që të shkonte nga Medina në Kufe dhe atje (në Kufet) të merrte në dorë udhëheqjen.

Imam Hysejni (Paqja qoftë mbi të!) dërgoi tek ata djalin e xhaxhait të tij, Myslim ibn Akijlin që të verifikonte situatën në Kufe dhe të merrte në dorë përkohësisht udhëheqjen, derisa të mbërrinte imam Hysejni (Paqja qoftë

mbi të!). Myslimi mbërriti në Kufe. Pas tij, imam Hysejni doli nga Medinia dhe u nis për në Kufe.

Mirëpo, kur e mori vesh Jezidi, urdhëroi shkarkimin e mëkëmbësit të Kufes dhe mëkëmbësin e Basrës, Ubejdullah ibn Zijadin e dërgoi mëkëmbës në Kufe. Ai i dha atij të gjitha kompetencat dhe të vepronte si të ishte më e dobishme për të ndrequr situatën në Kufe dhe të përdorte metoda të ndryshme.

Kur Ubejdullah ibn Zijadi mbërriti në Kufe, bëri këto veprime:

1- Kërkoi mbështetjen e pasuesve të emevitëve në Kufe.

2- Bleu me para njerëzit lakmitarë.

3- Me ndihmën e spiunëve të tij, arrestoi shumicën e udhëheqësve të lëvizjes ndarëse dhe njerëzit e rëndësishëm prej pasuesve të tyre.

4- Përdori politikën e joshjes e të terrorit ndaj njerëzve për t'i larguar nga Myslim ibn Akijli.

5- Vrau Muslim ibn Akiljin.

6- Përgatiti ushtrinë për të luftuar imam Hysejnin (Paqja qoftë mbi të!). Këtë ushtri e formoi me pasues të emevitëve, me ata që bleu me para dhe me ata me personalitet të dobët.

7- Udhëhoqi ushtrinë që formoi me ata që i bleu dhe i joshi me para e me poste të larta në qeverisje.

8- Një pjesë të ushtrisë e dërgoi për t'u përballur me imam Hysejnin para se ai të hynte në Kufe, ta bllokonin atë në një vend ku të mos hynte dot dhe ta nxirrnin nga Iraku.

Ushtarët u takuan me imam Hysejnin (Paqja qoftë mbi të!) dhe e rrethuan në Kerbela.

9- Pas rrethimit të imam Hysejnit në Kerbela, Ubejdullah ibn Zijadi e dërgoi të gjithë ushtrinë e tij që formoi për ta luftuar imamin. Ushtria përbëhej prej dhjetëra mijëra ushtarësh. Ushtria e imam Hysejnit (Paqja qoftë mbi të!) kishte më pak se njëqind luftëtarë. Mes dy ushtrive filloi beteja dhe rezultati i saj ishte martirizimi i imam Hysejnit (Paqja qoftë mbi të!) së bashku me shokët e tij. Kjo ndodhi pasi komandanti i ushtrisë emevite i tha që të zgjidhte ose nënshtrimin ndaj udhëheqjes së Jezid bin Muavijes ose vrasjen dhe dërgimin e kokës së tij te Jezidi.

Imam Hysejni (Paqja qoftë mbi të!) zgjodhi martirizimin dhe kundërshtoi politikën e padrejtë e të shthurur të Jezidit. Ai zbatoi detyrën fetare që e bën çdo mysliman të sakrifikojë në situatat kur dështojnë të gjitha mjetet për të kundërshtuar devijimin e udhëheqjes emevite dhe padrejtësinë e tyre. Myslimanët duhet të përfitojnë nga sakrifica e imam Hysejnit për të kundërshtuar çdo udhëheqje të devijuar e të padrejtë.

Dobitë më të rëndësishme që përfituan myslimanët prej martirizimit të imam Hysejnit (Paqja qoftë mbi të!) **ishin:**

1- Martirizimi i imamit zbuloi të vërtetën e sundimit emevit dhe sqaroi se të mbuluarit e tyre me petkun e Islamit ishte një mashtrim për myslimanët.

2- Martirizimi i imam Hysejnit (Paqja qoftë mbi të!) përçoi ndjenjën e përgjegjësisë tek myslimanët e vetëdijshëm dhe ishte faktor i revolucionit të të penduarve (theuretu teabijne).

3- Martirizimi i imam Hysejnit (Paqja qoftë mbi të!) i nxiti dhe i inkurajoi myslimanët që të bënin revolucione të njëpasnjëshme kundër udhëheqjes emevite. Prej tyre ishin revolucionet alevite.

4- Martirizimi i imam Hysejnit (Paqja qoftë mbi të!) ishte faktori kryesor i rënies së sundimit emevit.[4]

Vdekja e tij

Imam Hysejni (Paqja qoftë mbi të!) ra dëshmor në Kerbela ditën e dhjetë të muajit Muharrem në vitin 61 të hixhrit.

Prej porosive të tij

1- "*O ju njerëz! Vërtet, i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: 'Kush sheh një sulltan të devijuar, që haramin e ka bërë hallall, ka shkelur besëlidhjen e Tij, kundërshtues të synetit të të Dërguarit. Ai vepron tek robtë e Allahut me gjynahe e terror dhe nuk e ndryshon këtë as me fjalë e as me vepra. Është e drejta e Allahut që këtë njeri ta fusë në Xhehenem.'*"

2- "*Allahu i Madhëruar thotë: '**Besimtarët dhe besimtaret janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen***

[4] Për më shumë informacione, shiko librin "*Theuretul Husein*", i po të njëjtit autor.

vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat...' *(Sure "Teube", ajeti 71). Allahu urdhëron në bërjen e veprave të mira dhe në ndalimin e veprave të këqija. Kjo është detyrë nga ana e Tij, sepse Ai e di se nëse do të zbaohen këto urdhra, të gjitha detyrimet do të jenë të qëndrueshme e të vazhdueshme - e lehta e tyre dhe e vështira e tyre. Kjo, sepse urdhërimi në të mira dhe ndalimi nga e keqja është thirrje në Islam për të kundërshtuar të padrejtët dhe padrejtësitë."*

IMAM ALIU, I BIRI I IMAM HYSEJNIT

(Paqja qoftë mbi të!)

Ai është Aliu, i biri i Hysejnit, i biri i Aliut, i biri i Ebu Talibit (Paqja qoftë mbi ta!).

Lindja e tij

Imam Aliu, i biri i imam Hysejnit (Paqja qoftë mbi të!) ka lindur në Medinen e Ndritur, në vitin 38 të hixhrit.

Imamati i tij

Imam Aliu, i biri i imam Hysejnit (Paqja qoftë mbi të!) e filloi misionin e udhëheqësisë pas martirizimit të babait, imam Hysejnit (Paqja qoftë mbi të!), në vitin 61 të hixhrit.

Gjatë kohës së udhëheqësisë (imamatit) së tij, ai u përball me presione, vështirësi e ashpërsi të ndryshme nga ana e sundimit emevit. Atij i vendosën një mbikëqyrje mbytëse duke i vënë pas spiunë e përndjekës, me qëllim që



të mos vazhdonte rrugëtimin e thirrjes islame. Mirëpo, të gjitha planet e emevitëve ndaj imam Aliut, të birit të imam Hysejnit (Paqja qoftë mbi të!), nuk arritën ta pengonin atë në rrugëtimin e thirrjes islame. Imami (Paqja qoftë mbi të!) përdori si metodologji për përhapjen e Islamit dhe luftimin e emevitëve, porositë, këshillat dhe lutjet. Të gjitha lutjet e tij janë të tubuara në një libër të vetëm që quhet "Sahife Saxhadije". Imami njihet edhe me emrat: Zejnul Abidijn dhe Saxhad.

Vdekja e tij

Imam Aliu, i biri i imam Hysejnit, ka vdekur në Medinen e Ndritur, në vitin 94 të hixhrit.

Prej lutjeve të tij udhëzuese

"O Zoti im! Bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit! Na mbarëso neve në këtë ditë, në këtë natë dhe në të gjitha ditët tona, që të bëjmë të mirën dhe të braktisim të keqen, të falënderojmë mirësitë, të ndjekim dispozitat e Sheriatit islam, të largohemi nga risitë, të urdhërojmë në të mira dhe të ndalojmë të keqen, të mbrojmë Islamin, të kundërshtojmë të kotën, të përkrahim të drejtën e të vërtetën dhe t'i përhapim ato, të udhëzojmë të humburit nga rruga e drejtë, të ndihmojmë të dobëtit e të paaftit dhe të përkrahim nevojtarët!"

"Es Sahife Saxhadije"

Ky libër përmban lutjet e imam Aliut, të birit të imam Hysejnit (Paqja qoftë mbi të!).

Tubimi i tij

Libri "Sahife Saxhadije" është grumbulluar në kohën e imam Aliut, të birit të imam Hysejnit (Paqja qoftë mbi të!) dhe prej tij u shkruan dy kopje. Një kopje e mbajti djali i imam Bakir (Paqja qoftë mbi të!), të cilën e trashëguan imamët e pamëkatë pas tij. Kopjen tjetër e mbajti djali i tij, Zejdi, të cilën e trashëguan fëmijët e tij.
Më pas, u shkruan disa kopje të tjera nga disa dijetarë myslimanë, të cilat përmbajnë lutjet e dy kopjeve të para.

Rëndësia e "Sahife Saxhadije"

Ky libër ka një rëndësi të madhe në mesin e myslimanëve. Ata janë kujdesur shumë për të dhe akoma vazhdon të jetë në qendër të vëmendjes e të kujdesjes.
Rëndësia e këtij libri:

1- Ai është libër me lutje dhe lutja është prej të pëlqyeshmeve (mustehabat) më të rëndësishme në Islam.

2- Ai konsiderohet pikë referimi për gjuhën arabe dhe letërsinë e saj.

3- Ai konsiderohet pikë referimi për dijet e besimit islam.

4- Ai konsiderohet pikë referimi për shkencën e moralin.

5- Ai konsiderohet pikë referimi për njohuritë e përgjithshme.



Përmbajtja e tij

"Sahife Saxhadije" përmban 54 dua (lutje). Prej duave të mrekullueshe të tij, janë: Dua "Mekarimul Akhlak" (lutja e moraleve të mira), dua "Es Sabah" (lutja e mëngjesit) dhe dua "El Mesa'u" (lutja e darkës).

Prej lutjeve të Sahife-s

Lutja e imamit (Paqja qoftë mbi të!) për fqinjët

"O Zoti im! Bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit! Bëj që unë të punoj me mendimin e mirë për të gjithë ata e për të gjithë të bëj sa më shumë të mira; bëj që unë të ul syrin tim ndaj nderit të tyre; bëj që unë të sillem me kryeultësi e butësi ndaj tyre! Nga mëshira për ta, bëj që të jem dashamirës me ata që janë goditur nga ndonjë fatkeqësi e rëndë, të tregoj dashuri zemre në fshehtësi ndaj tyre! Bëj që dëshira ime për qëndrimin e mirësive në ata të jetë këshillë për to dhe të vërtetoj për ata atë që është detyrë të vërtetoj për njerëzit e mi më të afërm dhe bëj që unë të kujdesem për ata, njëlloj si për ata që dua më shumë! O Zoti im dhuro paqe dhe shpëtim për Muhamedin e për familjen e tij dhe me këtë mirësi që ata kanë më furnizo edhe mua! Bëj për mua pjesë sa më shumë nga ajo që është tek ata! Shtoje diturinë e tyre për të drejtat e mia të pamohueshme! Bëj që unë të arrijë gradë të lartë, sa ata të jenë të lumtur me mua dhe unë të jem më i lumtur me ata! Pranoje këtë lutje, o Zot i botëve!"

“Mesazhi i të drejtave” (Risaletul hukuk)

Këto janë një grumbull mësimesh të imam Aliut, të birit të imam Hysejnit (Paqja qoftë mbi të!), që përmbajnë të drejta të ndryshme njerëzore.

Përmbajtja e tij

Ky libër përmban 50 të drejta, në të cilat imami (Paqja qoftë mbi të!) ka përmbledhur mësimet e tij islame. Prej atyre, janë:

1- Të drejtat e Allahut të Madhëruar.
2- Të drejtat e individit.
3- Të drejtat e familjes.
4- Të drejtat e shoqërisë.
5- Të drejtat e shtetit.

Prej mesazhit të të drejtave

E drejta e shokut:

“E drejta që ka mbi ty shoku, është që ti ta shoqërosh atë me nderim kurdo që të gjesh rastin, qoftë edhe me pak drejtësi; ta nderosh shokun siç të nderon ai ty; ta ruash atë ashtu siç të ruan ai ty; të mos ia kalosh në bujari në gjërat që keni ndërmjet njëri-tjetrit; nëse ai ta kalon ty, atëherë edhe ti shpërbleje me të njëjtën masë; mos trego ndaj tij dashuri më pak se sa meriton; angazhohu ta këshillosh atë, t’i rrish pranë e ta kundërshtosh kur është fjala për mosbindje ndaj Allahut, ta ndihmosh atë që të mos bëjë atë që i thotë mendja dhe të kundërshtojë urdhrat e Zotit. Për shokun të kesh mëshirë dhe jo dënim. Nuk ka tjetër fuqi, përveç Allahut.”

IMAM MUHAMED BAKIR

(Paqja qoftë mbi të!)

Ai është Muhamedi, i biri i Aliut, i biri i Hysejnit, i biri i Aliut, i biri i Ebu Talibit.

Lindja e tij

Ai ka lindur në Medinen e Ndritur, në vitin 57 të hixhrit.

Imamati i tij

Koha e imamatit të Imam Bakir (Paqja qoftë mbi të!) filloi pas vdekjes së babait, imam Aliut, të birit të imam Hysejnit (Paqja qoftë mbi të!), në vitin 94 të hixhrit.

Prej punëve më të rëndësishme që ai bëri në kohën e imamatit të tij, ishin:

1- Aktivizimi i lëvizjes mendore e ideologjike pas dobësisë së saj në kohën e sundimit të Muaviut, të birit të Ebu Sufjanit.

2- Ringjallja e Sheriatit islam, duke e rikthyer jurisprudencën islame në jetën e shoqërisë islame. Rreth kësaj çështjeje, imam Bakirin (Paqja qoftë mbi të!) e

ndihmuan edhe rrethanat e asaj kohe, sepse ai jetoi në kohën e fundit të sundimit emevit. Ishte një periudhë që ky sundim ishte dobësur për shkak të shumë faktorëve.

Faktorët më kryesorë që shkaktuan rënien e sundimit emevit, ishin:

1- Vrasja nga ana e emevitëve e personaliteteve të njohura në mesin e myslimanëve, si: Mejthem Temmar, Rashijd El Hixhrij, Amr ibn Hamk El Khuzaij, Hixhr ibn Udej El Kindij.

2- Vrasja e imam Hysejnit (Paqja qoftë mbi të!) në tokën e Kerbelasë.

3- Shkatërrimi i Medines së Ndritur nga ana e emeviteve në betejën El Huretu.

4- Goditja e Qabes së Bekuar me katapulte nga ana e emevitëve.

5- Revolucionet e njëpasnjëshme të alevitëve për të rrëzuar sundimin emevit.

6 – Pakujdesia e shumicës së udhëheqësve emevit dhe kundërshtimi i Sheriatit islam në sjelljet e tyre individuale.

7- Mospërfillja e qëndrimit të myslimanëve për pakënaqësinë e tyre ndaj udhëheqjes emevite.

Vdekja e tij

Imam Muhamed Bakir (Paqja qoftë mbi të!) vdiq në Medinen e Ndritur, në vitin 114 të hixhrit.



Prej thënieve të tij udhëzuese

1- *"O biri im! Kujdes nga dembelllëku dhe mërzitja, sepse ato janë çelësi i të gjitha të këqijave. Nëse dembelosesh, nuk e zbaton të drejtën dhe të vërtetën dhe nëse mërzitesh, nuk do të durosh ndaj së vërtetës dhe së drejtës."*

2- *"Është e keqe për njeriun që të shohë te të tjerët ato të meta që e verbojnë të shohë të metat e veta, të urdhërojë njerëzit për ato që ai vetë nuk mund t'i ndryshojë dhe t'i bëjë keq atij që rri me të, duke folur për ato që nuk i takon të flasë."*

3- *"Vërtet, kjo gjuhë është çelësi i të gjitha të mirave dhe të këqijave. Duhet që besimtari ta ruajë gjuhën e tij ashtu siç ruan floririn dhe argjendin e tij, sepse i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: 'Allahu e mëshiroftë atë besimtar që e ruan gjuhën e tij nga çdo e keqe.'"*

4- *"Vërtet, ndjekësit (shiat) tanë janë ata që i frikësohen Allahut dhe i binden Atij. Ata njihen me modestinë e thjeshtësinë, me frikën, me mbajtjen e amanetit, me përmendjen e shumtë të Allahut, me agjërimin, me namazin, me mirësjelljen ndaj prindërve, me respektimin e komshinjve, të të varfërve, të jetimëve, me thënien e së vërtetës, me leximin e Kur'anit dhe me mosbërjen keq njerëzve me gjuhët e tyre."*

IMAM XHAFERR SADIKU

(Paqja qoftë mbi të!)

Ai është Xhaferri, i biri i Muhamedit, i biri i Aliut, i biri i Hysejnit, i biri i Aliut, i biri i Ebu Talibit (Paqja qoftë mbi ta!).

Lindja e tij

Ai ka lindur në Medinen e Ndritur, në vitin 83 të hixhrit.

Imamati i tij

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) e filloi udhëheqësinë (imamatin) e tij pas vdekjes së babait, në vitin 114 të hixhrit.

Situata politike në kohën e imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) ishte ndihmuesë për të për të kryer përgjegjësinë e tij islame me cilësinë e imamit. Rrethanat i krijuan atij mundësinë e përhapjes së Islamit nëpërmjet rrugës së mendimit dhe të edukimit. Shkolla (medreseja) e tij në Fikh (Jurisprudencë) dhe Hadith ishte më e madhja



që ka njohur historia islame. Numri i nxënësve të saj arriti afërsisht në katër mijë.

Disa prej tyre, bazuar në ligjëratat e imam Sadikut (paqja qoftë mbi të!), shkruan katërqind libra në fusha të ndryshme të shkencave islame. Këto shkrime janë quajtur *El Usul el Erbamieh* (Katërqind parimet). Kjo ndikoi shumë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore islame dhe në përcjelljen e saj te brezat islamë.

Prej punëve më të rëndësishme që bëri imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!), ishin:

1- Pastrimi i besimit islam nga ato shtesa që u futën në të dhe nga devijimet për shkak të dyshimeve që përhapën jobesimtarët rreth besimit të drejtë islam.

2- Formimi i personaliteteve islame, siç ishin: Hisham ibn Hakem, Muhamed ibn Myslim dhe Zuraratu ibn A'jun.

3- Pastrimi i Sheriatit islam nga ndryshimet dhe nga devijimet që sollën duart dashakeqëse.

Faktorët më të rëndësishëm që e ndihmuan imam Sadikun (Paqja qoftë mbi të!) në kryerjen e misionit të tij, ishin:

1- Periudha e ardhjes së pushtetit abasit. Në kohën e imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!), abasitët mendonin për forcimin e pushtetit të tyre të sapoardhur.

2- Qëndrimi i Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) në Medinen e Ndritur, që ishte qendra e fesë, e cila nderohej dhe madhështohej nga ana e pushtetit.

3- Pozita e lartë fetare dhe shoqërore e Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) te myslimanët. Për këtë pozitë kujdesej edhe pushteti.

4- Distancimi i Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) nga konflikti politik, sepse ai ishte i ditur se nuk e arrinte udhëheqjen politike si rezultat i ndodhive politiko - sociale që i përjetoi në atë kohë.

5- Vështrimi i myslimanëve kah juristët (fukahatë) për të mësuar çështjet islame prej tyre. Në atë kohë nuk gjedej asnjë sahabi i profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ishte juristi më i madh i myslimanëve dhe mësuesi i juristëve të tyre.

Vdekja e tij

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka vdekur në Medinen e Ndritur, në vitin 148 të hixhrit.

Prej thënieve të tij udhëzuese

1- "*O biri im! Ji lexues i Librit të Allahut, përhapës i Islamit, urdhërues në të mira, ndalues nga e keqja, mbajtës i lidhjeve me atë që i shkëput, dhënës për atë që kërkon! Ruhu nga thashethemi, sepse ai mbjell urrejtje në zemrat e njerëzve!*"

2- "*Ai që ecën për t'i përmbushur një nevojë vëllait të tij, është si ai që ecën mes Merves dhe Safasë. Ai që ia përmbush nevojën vëllait të tij, është si dëshmori në rrugën e Allahut në betejën e Bedrit dhe të Uhudit. Allahu nuk e dënon një popull,*

veçse për shkak të shkeljes së të drejtave të fukarenjve dhe të vëllezërve të tyre."

3- *"Lajmëroji ndjekësit (shiat) tanë dhe thuaji atyre: 'Mos u përçani! Betohem në Allahun, se vilajeti ynë nuk fitohet veçse me devotshmëri, me përpjekje e sakrifica në fe dhe me simpati (el muvasat) ndaj vëllezërve për hir të Allahut. Nuk është prej ndjekësve (shiave) ai që i bën padrejtësi njerëzve."*

IMAM MUSA KADHIM

(Paqja qoftë mbi të!)

Ai është Musai, i biri i Xhaferrit, i biri i Muhamedit, i biri i Aliut, i biri i Hysejnit, i biri i Aliut, i biri i Ebu Talibit (Paqja qoftë mbi ta!).

Lindja e tij

Imam Kadhim (Paqja qoftë mbi të!) ka lindur në fshatin El Ebvau, që ndodhet mes Mekës dhe Medines, në vitin 128 të hixhrit.

Imamati i tij

Imam Kadhim (Paqja qoftë mbi të!) e filloi udhëheqësinë (imamatin) e tij pas vdekjes së babait, imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!), në vitin 148 të hixhrit.

Prej punëve më të rëndësishme të imam Kadhim (Paqja qoftë mbi të!) **ishin:**

Pjesëmarrja e tij me myslimanët në rezistencën kundër devijimit të sundimit abasit. Lëvizja e myslimanëve

kundër devijimit abasit në atë kohë ishte e fortë dhe e përhapur. Kjo bëri që imam Kadhim (Paqja qoftë mbi të!) të mbante qëndrim kundërshtues ndaj qeverisjes abasite, duke kryer përgjegjësinë e tij islame për të zhdukur devijimin e abasitëve nga mësimet dhe dispozitat islame.

Udhëheqësit abasitë shpenzonin pa kriter pasuritë e myslimanëve, ndërkohë që Sheriati islam e urdhëron udhëheqësin e myslimanëve që të bëjë barazi në mesin e tyre me qëllim që të zhduket varfëria te myslimanët. Është detyrë e udhëheqësit që t'ia largojë dhimbjet dhe vështirësitë të varfërit dhe t'i mundësojë një jetë të lehtë e të ndershme. Të shumtë ishin të uriturit dhe të zhveshurit në shtetin abasit, por fatkeqësisht, askush nuk intersohej për ta, përveç Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!).

Në atë kohë shteti abasit udhëhiqej nga Harun Rashidi. Kur mësoi se imam Kadhim kishte qëndrim të kundërt ndaj abasitëve, Haruni vendosi mbikëqyrje të ashpër ndaj imamit dhe përkrahësit e lëvizjes antiabasite i burgosi e i vrau.

Prej frikës së lëvizjes dhe zgjerimit të saj, Harun Rashidi e mori imam Kadhimin në Irak dhe e burgosi në Basra. Më pas, e transferoi në burgun e Bagdadit. Edhe pse ishte në burg, imam Kadhim kontaktonte me ndjekësit e tij. Ata shkëmbenin shkresa dhe kujdeseshin për lëvizjen antiabasite. Kur abasitët e morën vesh këtë, e ashpërsuan më shumë mbikëqyrjen ndaj imamit, derisa e ekzekutuan.

Vdekja e tij

Imam Kadhim (Paqja qoftë mbi të!) vdiq në Bagdad, në vitin 183 të hixhrit.

Prej thënieve të tij udhëzuese

1-"O biri im! Ruhu që Allahu mos të të shohë në gjynahin që ta ka ndaluar! Ruhu nga devijimi dhe moszbatimi i asaj për të cilën të ka urdhëruar Allahu! Ji serioz! Ruhu nga shakaja, sepse ajo ta largon dritën e besimit tënd dhe të ul personalitetin tënd! Ruhu nga dembelizmi dhe mërzija, sepse ato të ndalojnë ty të mirat e kësaj jete dhe të Jetës Tjetër!"

2- *"Nuk është prej nesh ai që nuk e shikon dhe vlerëson veten e tij për çdo ditë. Nëse ka bërë të mira, të kërkojë shtimin e tyre; nëse ka bërë të këqija, t'i kërkojë falje Allahut dhe të pendohet!"*

3- *"Prediko të mirën dhe thuaje atë! Mos ji hipokrit dhe mos thuaj: 'Unë jam me njerëzit, unë jam një prej njerëzve, sepse i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: O ju njerëz! Ato janë dy rrugë - rruga e së mirës dhe rruga e së keqes. Kurrë të mos jetë rruga e së keqes më e dashur te ju sesa rruga e së mirës!'"*

IMAM ALI RIZAI

(Paqja qoftë mbi të!)

Ai është Aliu, i biri i Musait, i biri i Xhaferrit, i biri i Muhamedit, i biri i Aliut, i biri i Hysejnit, i biri i Aliut, i biri i Ebu Talibit (Paqja qoftë mbi ta!).

Lindja e tij

Imam Ali Rizai (Paqja qoftë mbi të!) ka lindur në Medinen e Ndritur, në vitin 153 të hixhrit.

Imamati i tij

Imam Rizai (Paqja qoftë mbi të!) e filloi udhëheqësinë (imamatin) e tij pas vdekjes së babait, imam Kadhim (Paqja qoftë mbi të!), në vitin 183 të hixhrit.

Prej punëve më të rëndësishme të imam Rizai (Paqja qoftë mbi të!) **ishin:**

1- Sqarimi i besimit islam dhe pastrimi i tij prej devijimeve që u përhapën në fillim të pushtetit abasit.

2- Mësimdhënia e rregullave dhe e dispozitave të fesë, si dhe përhapja e haditheve të Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!).

3- Sqarimi dhe konstatimi se imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ishte prijës i besimtarëve menjëherë pas profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe se ai e meritonte plotësisht këtë pozitë.

Vilajeti i Ahdit

Në kohën e imamatit të imam Rizait (Paqja qoftë mbi të!), Me'muni, udhëheqësi abasit i asaj kohe, zgjodhi imamin Veliju Ahdin. Këtë e bëri për shkak të faktorëve të mëposhtëm politik:

1- Animi i njerëzve të xhaxhallarëve të Me'munit kah vëllait të tij, Eminit, për t'i tërhequr ata kah vetes nga frika se pushteti të mos kalonte nga abasitët tek alevitët.

2- Përpjekja e Me'munit për të shtypur e për të shkrirë lëvizjet politike që ftonin në rrugën e Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi të!) dhe këto lëvizje të mos përfitonin nga hendeku i mosmarrëveshjes mes Me'munit dhe vëllait të tij, Eminit dhe nga përçarja e abasitëve për pushtet.

3- Përpjekja e Me'munit që pasuesit e Imam Rizait (Paqja qoftë mbi të!) t'i tërhiqte nga ana e tij për të shtuar fuqinë e tij kundër përkrahësve të vëllait të tij, Eminit.

Kjo përpjekje e Me'munit, përveç Vilajetit të Ahdit, bazohej edhe në:



1- Pohimin e Me'munit se imamët e Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!) e meritonin më shumë se abasitët udhëheqësinë (khilafetin). Këtë pohim e ka shprehur qartë edhe në diskutimet dhe dialogjet e tij, si dhe në tekstin e vilajetit të Ahdit.

2- Prodhimin e monedhës nga Me'muni me emrin e imam Rizait (Paqja qoftë mbi të!).

3- Vendosjen e imam Rizait drejtpërsëdrejti nën mbikëqyrjen e tij, me qëllim që imami të mos bëntë asnjë aktivitet politik kundër abasitëve.

Vdekja e tij

Imam Rizai (Paqja qoftë mbi të!) vdiq në qytetin Tus, krahinën e Khorasanit (Mashhadi i sotëm), në vitin 203 të hixhrit.

Prej thënieve të tij udhëzuese

1- "Përkrahja dhe ndihma jote për të dobëtin dhe të paaftin është më e mirë se sadakaja."

2- "Prej moralit të profetëve, është pastërtia."

3- "Njerëzit e mirë janë ata, të cilët, kur bëjnë mirë, përgëzojnë; kur bëjnë keq, kërkojnë falje dhe kur u jepet diçka, falënderojnë për të."

4- "Mbaji lidhjet me të afërmit e tu, qoftë edhe me nje gllënkë uji!"

Prej lutjeve të tij

"O Zoti Im! Më jep udhëzim dhe më forco në të; më tubo të udhëzuar e të sigurtë nga çdo frikë e hidhërim! Vërtet, Ti je Poseduesi i devotshmërisë dhe i faljes e mëshirës."

Imam Muhamed Xhevad (Paqja qoftë mbi të!)

Ai është Muhamedi, i biri i Aliut, i biri i Musait, i biri i Xhaferrit, i biri i Muhamedit, i biri i Aliut, i biri i Hysejnit, i biri i Aliut, i biri i Ebu Talibit (Paqja qoftë mbi ta!).

Lindja e tij

Imam Muhamed Xhevadi (Paqja qoftë mbi të!) ka lindur në Medinen e Ndritur, në vitin 195 të hixhrit.

Imamati i tij

Imam Xhevadi (Paqja qoftë mbi të!) e filloi udhëheqësinë (imamatin) e tij pas vdekjes së babait, imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), në vitin 203 të hixhrit.

Kur vdiq babai i tij, imam Rizai (Paqja qoftë mbi të!), Me'muni e solli imam Xhevadin në Bagdad për shkaqet e mëposhtme:

1- Ta kishte në mbikëqyrje të drejtpërdrejtë imamin.

2- Të tërhiqte pasuesit e imam Xhevadit (Paqja qoftë mbi të!) nga ana e tij dhe të sigurohej nga qëndrimet e tyre kundërshtuese ndaj pushtetit abasit.

Afrimi i imam Xhevadit (Paqja qoftë mbi të!) nga ana e Me'munit ndikoi keq tek abasitët dhe ata mbajtën



qëndrim kundërshtues ndaj tij. Ata u përpoqën ta përçmonin imam Xhevadin (Paqja qoftë mbi të!) dhe të hidhnin dyshime rreth imamatit (udhëheqësisë) të tij sepse ishte i vogël në moshë. Mirëpo, Me'muni i ftoi ata që të zbulonin të vërtetën e imam Xhevadit (Paqja qoftë mbi të!) për njerëzit. Nëse situata do të ishte ashtu siç thonin ata, atëherë ai nuk do ta meritonte imamatin.

U organizuan tubime diskutimi me imam Xhevadin (Paqja qoftë mbi të!), në të cilat morën pjesë dijetarë të njohur të Sheriatit në atë kohë, siç ishte Jahja ibn Ekthem. Në këto tubime u diskutuan çështjet më të rëndësishme të Sheriatit islam. Rezultati i atyre tubimeve ishte triumfi i imam Xhevadit (Paqja qoftë mbi të!) dhe të qënit mbi dijetarët e tjerë në të gjitha ato çështje që u diskutuan. Kjo nxori në pah se imam Xhevadi (Paqja qoftë mbi të!) e meritonte plotësisht dhe me Sheriat postin e imamit që ai gëzonte.

Më pas, imam Xhevadi (Paqja qoftë mbi të!) u kthye në Medinen e Ndritur, pasi kreu haxhin dhe qëndroi atje deri në vdekjen e Me'munit.

Vdekja e tij

Kur vdiq Me'muni dhe e pasoi vëllai i tij Mu'tesami, ky i fundit e solli përsëri imam Xhevadin (Paqja qoftë mbi të!) në Bagdad. Imami qëndroi në Bagdad deri në fund të vitit që mbërriti në të dhe vdiq aty në vitin 220 të hixhrit.

Prej thënieve të tij udhëzuese

1- *"Mos u bëj armik i askujt, derisa ta kuptosh atë që ndodhet mes tij dhe Allahut!"*

2- *"Mos ji mik i Allahut në dukje dhe armik i Tij në fshehtësi!"*

3- *"Besimtari ka nevojë për mbarësinë e Allahut, për këshillues dhe për pranim të atij që e këshillon."*

4- *"Vonesa e pendimit është vetëkënaqësi; zvarritja e gjatë është çoroditje; justifikimet ndaj Allahut janë shkatërrim."*

5- *"Kujdes kur e shfaq dhe e tregon diçka para se ajo të jetë realizuar!"*

6- *"Dije se ty të sheh gjithmonë Allahu, prandaj shiko se si je!"*

IMAM ALI EL HADIJ

(Paqja qoftë mbi të!)

Ai është Aliu, i biri i Muhamedit, i biri i Aliut, i biri i Musait, i biri i Xhaferrit, i biri i Muhamedit, i biri i Aliut, i biri i Hysejnit, i biri i Aliut, i biri i Ebu Talibit (Paqja qoftë mbi ta!).

Lindja e tij

Imam Ali El Hadij (Paqja qoftë mbi të!) ka lindur në Medinen e Ndritur, në vitin 212 të hixhrit.

Imamati i tij

Imam Ali El Hadij (Paqja qoftë mbi të!) e filloi udhëheqësinë (imamatin) e tij pas vdekjes së babait të vet, imam Xhevadit (Paqja qoftë mbi të!), në vitin 220 të hixhrit.

Në kohën e udhëheqësisë së imam Ali El Hadij (Paqja qoftë mbi të!), lëvizjet e ndjekësve të Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!) u zgjeruan dhe u forcuan. Për pak mund të bëhej revolucioni ndarës mes Hixhazit dhe pushtetit abasit.

Mëkëmbësi i Medines shkroi një raport për Mutevekelin, udhëheqësin abasit të asaj kohe, duke e informuar rreth kësaj lëvizjeje dhe veprimtarisë së saj. Atëherë, Mutevekeli dërgoi një delegacion nga ana e tij për të parë gjendjen në Medinen e Ndritur dhe të njiheshin nga afër me atë lëvizje. Ai e dërgoi imam Ali El Hadij (Paqja qoftë mbi të!) në Samarra (qytet i Irakut).

Kur delegacioni abasit mbërrit në Medine ai veproi si vijon:

1- Kontrolloi shtëpinë e imam Ali El Hadij (Paqja qoftë mbi të!). Mirëpo aty gjetën veçse Kur'anë, libër lutjesh dhe libra diturish të tjera.

2- Njoftoi dërgimin e imam Ali El Hadij në Irak. Kjo gjë shkaktoi rrëmujë të madhe, kundërshtime nga ana e banorëve të Medines. Pas bindjes së banorëve, ata e morën imamin (Paqja qoftë mbi të!) për në Irak, jo për qëllim urrejtjeje e armiqësie ndaj pushtetit abasit, por sepse udhëheqësit në Irak kishin nevojë për imam Ali El Hadij (Paqja qoftë mbi të!).

Për t'i bindur njerëzit, delegacioni abasit bëri disa veprime, si:

1- Shkarkoi mëkëmbësin e Medines, sepse ai u soll keq me imam Ali El Hadij (Paqja qoftë mbi të!).

2- Përhapi letrën që Mutevekeli i dërgoi imam Ali El Hadij (Paqja qoftë mbi të!) në mesin e njerëzve.

Përmbajtja e letrës ishte:

1- Shkarkimi i mëkëmbësit të Medines.

2- Përmallimi i Mutevekelit për imam Ali El Hadij (Paqja qoftë mbi të!) dhe nevoja e udhëheqësve në Irak për të.

Së fundi, imami u dërgua në Irak. Sapo mbërriti në Samarra (kryeqyteti i pushtetit abasit në atë kohë), imami shkoi në shtëpinë që ishte përgatitur për të. Pasuesit e tij filluan të kontaktonin haptazi dhe fshehtazi me imam Ali El Hadij (Paqja qoftë mbi të!). Raportimet kundër imamit u shtuan te Mutevekeli. Ato raportime përmbanin:

1- Në shtëpinë e imam Ali El Hadij (Paqja qoftë mbi të!) gjenden shkresa politike dhe armë.

2- Imam Ali El Hadij (Paqja qoftë mbi të!) është i vendosur për të bërë revolucion me qëllim rrëzimin e pushtetit abasit.

Këto raportime e shtynë Mutevekelin t'i urdhëronte xhandarët e tij turq që ta sulmonin natën shtëpinë e imam Ali El Hadij (Paqja qoftë mbi të!), ta kontrollonin atë dhe t'ia dërgonin imamin atij, ashtu siç ishte në kohën e sulmit të shtëpisë. Mirëpo kur e sulmuan shtëpinë e imam Ali El Hadij (Paqja qoftë mbi të!), nuk gjetën asgjë prej atyre që përmendeshin në raportime. Ata e gjetën imamin duke bërë ibadet (adhurim), të ulur në tokë duke lexuar Kur'anin e Shenjtë.

Qëndrimet e abasitëve ndaj imam Ali El Hadij (Paqja qoftë mbi të!) vazhduan në forma të ndryshme. Herë përdornin presionin, terrorin e kërcënimin e herë

tjetër, respektin e nderimin. E kjo varej se si e kërkonte situata.

Vdekja e tij

Imam Ali El Hadij (Paqja qoftë mbi të!) vdiq në Samarra, në vitin 254 të hixhrit.

Prej thënieve të tij udhëzuese

1- "*Konflikti e prish shoqërinë e vjetër dhe shkatërron lidhjet e forta. E pakta që gjendet në të është mposhtja, e cila është baza e shkaqeve të ndarjes.*"

2- "*Vërtet, udhëheqësi i padrejtë mund ta largojë padrejtësinë e tij me butësinë e tij. Dhe, i drejti mendjelehtë mund ta shuajë dritën e drejtësisë së tij me mendjelehtësinë e tij.*"

3- "*Kush është i pakujdesshëm ndaj vetes së tij, nuk ka siguri nga e keqja e tij.*"

4- "*Dynjaja është treg. Në të humbin disa njerëz dhe fitojnë disa të tjerë.*"

5- "Kush i frikësohet Allahut, është i ruajtur dhe kush i bindet Atij, është i respektuar."

6- "*Ai që i bindet Krijuesit, nuk interesohet për zemërimin e krijesave. Ai që e zemëron Krijuesin, të jetë i bindur se atë do ta përfshijë zemërimi i krijesave.*"

IMAM HASAN EL ASKERIU

(Paqja qoftë mbi të!)

Ai është Hasani, i biri i Aliut, i biri i Muhamedit, i biri i Aliut, i biri i Musait, i biri i Xhaferrit, i biri i Muhamedit, i biri i Aliut, i biri i Hysejnit, i biri i Aliut, i biri i Ebu Talibit (Paqja qoftë mbi ta!).

Lindja e tij

Imam Hasan El Askerij (Paqja qoftë mbi të!) ka lindur në Medinen e Ndritur, në vitin 221 të hixhrit.

Imamati i tij

Imam Hasan El Askerij (Paqja qoftë mbi të!) e filloi udhëheqësinë (imamatin) e tij pas vdekjes së babait, imam Xhevadit (Paqja qoftë mbi të!), në vitin 254 të hixhrit.

Në kohën e udhëheqësisë së imam Ali El Hadij (Paqja qoftë mbi të!) lëvizjet e ndjekësve të Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!) ishin të gjera, të fuqishme dhe përbënin rrezik për pushtetin abasit. Për shkak të raportimeve të

ndryshme, të kota e të pabaza, Mutevekeli e burgosi Imam Hasan Askeriun (Paqja qoftë mbi të!).

Në kohën e udhëheqësisë (imamatit) së imam El Hadij dhe imam El Askerij (Paqja qoftë mbi ta!), Mutevekeli abasit i përndoqi ashpër ndjekësit e dy imamëve duke përdorur terrorin, dhunën dhe vrasjen e tyre.

Vdekja e tij

Imam Hasan El Askerij (Paqja qoftë mbi të!) vdiq në Samarra, në vitin 260 të hixhrit.

Prej fjalëve të tij udhëzuese

1- Pjesë nga porosia e imam Hasan El Askerij (Paqja qoftë mbi të!) për ndjekësit (shiat) e tij: "*Vërtet, cilido prej jush që është i devotshëm në fenë e tij, që thotë të vërtetën, që e përcjell amanetin dhe që sillet mirë me njerëzit, i thuhet se është prej pasuesve tanë (shiit) dhe mua më gëzon kjo gjë.*"

"*Frikësohuni Allahut! Jini për ne zbukurim dhe jo shëmtim! Sillni për ne dashuri dhe largojeni prej nesh çdo të keqe! Vërtet, ajo e mirë që thuhet për ne, është e merituar dhe ajo e keqe që thuhet për ne, është e pavërtetë. E drejta jonë është edhe në Librin e Allahut*[5]*. Afrimiteti me të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e*

[5] E drejta e Ehli Bejtit në Kur'an është detyrimi i dashurisë ndaj tyre për të gjithë myslimanët, siç thotë ajeti: **"Thuaj: 'Nuk ju kërkoj për këtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmve**.'" Surja"Esh Shura", ajeti 23.

tij!) dhe pastrimi nga ana e Allahut, na takon vetëm neve. Kushdo tjetër që e pretendon këtë përveç nesh, është gënjeshtar."

2- *"Mos debato, se të ikën respekti! Mos bëj shaka, sepse të tjerët do të marrin guximin ta bëjnë ndaj teje."*

3- *"Prej shenjave shkatërruese të njeriut është kur fqinji i tij sheh një të mirë dhe e errëson (e mbulon) dhe kur sheh një të keqe, e përhap."*

4- *"Njeriu i keq është ai që ka dy fytyra dhe dy gjuhë. Ai e përshëndet vëllanë e tij kur është i pranishëm dhe e ha atë kur nuk është i pranishëm."*

IMAM MUHAMED EL MEHDI

(Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!)

Ai është Muhamedi, i biri i Hasanit, i biri i Aliut, i biri i Muhamedit, i biri i Aliut, i biri i Musait, i biri i Xhaferrit, i biri i Muhamedit, i biri i Aliut, i biri i Hysejnit, i biri i Aliut, i biri i Ebu Talibit (Paqja qoftë mbi ta!).
Imam Muhamed Mehdiu (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!) ka lindur në Samarra, në vitin 255 të hixhrit.

Imamati i tij

Imam Muhamed Mehdiu (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!) e filloi udhëheqësinë (imamatin) e tij pas vdekjes së babait, imam Hasan Askeriut (Paqja qoftë mbi të!), në vitin 260 të hixhrit.

Imam Mehdiu (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!) është shpëtimtari i njerëzimit, ardhjen e të cilit e përgëzojnë fetë qiellore. Ai do ta mbushë tokën me drejtësi e mirësi, pasi të jetë mbushur me padrejtësi e ligësi. Këtë e ka lajmëruar profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe imamët e tjerë të Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!).

Çështja e lindjes së tij është fshehur nga frika e pushtetit abasit, që kërkonte ta vriste.

Për imam Mehdiun (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!) ka dy të fshehta: Fshehja e Vogël (e shkurtër) dhe e Fshehja e Madhe (e gjatë).

Fshehja e Vogël (e shkurtër)

Kjo fshehje filloi me lindjen e imamit Mehiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!), në vitin 255 të hixhrit dhe përfundoi me vdekjen e përfaqësuesit të tij të katërt në vitin 328 të hixhrit.

Gjatë Fshehjes së vogël (të shkurtër), imami kontaktonte me pasuesit e tij nëpërmjet përfaqësuesve të tij në mënyrë të fshehtë. Ata përfaqësues ishin:

1- Uthman ibn Said El Umerij
2- Muhamed ibn Uthman El Umerij
3- Husein ibn Ruh En Neubekhtij
4- Ali ibn Muhamed Es Semerij

Fshehja e Madhe (e gjatë)

Kjo fshehje ka filluar kur vdiq përfaqësuesi i katërt i imam Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!), në vitin 328 të hixhrit dhe do të vazhdojë derisa Allahu ta urdhërojë ardhjen e tij.

Prania e imam Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!)

Prania e imam Mehdiut dhe jetëgjatësia e tij kanë lidhje me fuqinë e Allahut të Madhëruar. Përderisa Allahu e ka ngarkuar me misionin e ndreqjes e të shpëtimit të njerëzimit, po ashtu Ai i jep atij jetëgjatësinë njëlloj si me profetin Nuh (Paqja qoftë mbi të!). Profetit Nuh, Allahu i dha jetëgjatësi në kryerjen e misionit të predikimit e të udhëzimit të njerëzve. Ai jetoi 950 vjet, siç thotë Kur'ani i Shenjtë, duke e ftuar popullin e tij në rrugën e Allahut: **"Ne e dërguam Nuhun te populli i tij. Ai qëndroi tek ata një mijë pa pesëdhjetë vjet, e megjithatë, ata i përfshiu përmbytja, duke qenë keqbërës."**[6]

Shkenca e sotme ka konstatuar se njeriu mund të jetojë me mijëra vite. Disa dijetarë kanë kryer disa eksperimente në pjesë të ndryshme të trupit të njeriut, të kafshëve dhe të bimëve.

Prej këtyre eksperimenteve, janë ato të kryera në disa pjesë të nervave të njeriut, si në muskuj, në zemër, në lëkurë dhe në veshka. Gjatë këtyre eksperimenteve është vënë re se këto pjesë:

1- Përderisa ushqimi i duhur është i siguruar, ato qëndrojnë të gjalla e të fjetura.

2- Qelizat e tyre rriten dhe shumohen në varësi të ushqimit që përdoret.

[6] Sure "Ankebut", ajeti 14.



3- Koha nuk ndikon tek ato. Kjo do të thotë se ato as nuk plaken e as nuk dobësohen me kalimin e kohës. Madje atyre nuk u duket as gjurma më e paktë e plakjes. Përkundrazi, ato rriten dhe shtohen në këtë kohë, njësoj sikur rritej e shtohej në vitet e mëparshme.

4- Të gjitha dukuritë tregojnë se ato pjesë do të qëndrojnë të gjalla e në gjumë, për sa kohë studiuesit do të jenë të durueshëm në mbikëqyrjen e tyre dhe për sa kohë sigurimi i ushqimit të jetë i mjaftueshëm për to.[7]

Duaja e Pritjes (intidharit)

Kjo është një dua, me të cilën kërkohet ardhja e imam Mehdiut (Allahu ia shpejtoftë ardhjen!).

"O Zoti ynë! Ne dëshirojmë nga Ty, që me shtetin e nderuar (të imam Mehdiut) ta lartësosh Islamin dhe pasuesit e tij; ta poshtërosh hipokrizinë dhe ndjekësit e saj; të na bësh neve në atë shtet prej thirrësve në bindjen ndaj Teje, udhëheqës në rrugën Tënde; për hir të atij shteti, të na dhurosh dinjitet në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër."

[7] Për më shumë sqarime, lexoni librin e po këtij autori me titull: "Fi intidharul Imam", kreu "Vuxhudul Imam".

اَللّهُمَّ اِنّا نَرْغَبُ اِلَيْكَ في دَوْلَة كَريمَة تُعِزُّ بِهَا الإسلام وَاَهْلَهُ، وَتُذِلُّ بِهَا النِّفاقَ وَاَهْلَهُ، وَتَجْعَلُنا فيها مِنَ الدُّعاةِ اِلى طاعَتِكَ، وَالْقادَةِ اِلى سَبيلِكَ، وَتَرْزُقُنا بِها كَرامَةَ الدُّنْيا وَالاْخِرَة.

Falënderimet dhe lëvdatat janë për Allahun e Madhëruar.



ائمتنا (عليهم السلام)

اسم الكتاب: ائمتنا (عليهم السلام)

المؤلف: السيد حسين الصدر

المترجم: ولنت مريا

الاخراج النهائى: صبريه فزا

ناشر: الجمعية الأوربية لتعارف الاديان